



**VENDIM**

**Nr. 67 Datë 01.10.2009**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“ENERGJI ASHTA” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për t`u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Dhe konstatoi se:**

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

Paraqitjen e Oponencës Teknike të projektit është shoqeruar me informacionin për fillimin e punës për hartimin e saj (informacion i paraqitur nga aplikuesi dhe shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, METE, Nr.6294/3 Prot., dt.10.08.2009).

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të filloje procedurat për licensimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Ashta”.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

*VENDIMIN*

*Nr.67 Datë 01.10.2009*

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“ENERGJI ASHTA” SH.P.K.**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkelqim Bozgo</b>	_____	_____

